

## Gjokë (Sokol) Krasniqi

(2.05.1947, shqiptar nga fshati Meqe/Meçe, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, katër fëmijë)

Në datën **17.07.1998**, Gjokë Krasniqi ka shkuar në fshatin fqinj të Doblubarës/Doblubare. Prej këtij fshati, ai me Pjetër Gjiododun shkuan në Gjakovë/Đakovica për të blerë karburante për kombajnën e tyre. Në kthim, u ndalën në shtëpia e Pjetrit. Nga ora 14:00, Gjokë Krasniqi u nis në shtëpi me automobilin e vet. Familjarët e kanë pritur tërë natën, por ai nuk erdhi në shtëpi. Ditën tjetër, u nisën që ta kërkonin. Po atë ditë, Pjetri ka mësuar në shtabin e UÇK-së në Doblubarë/Doblubare, se te vendi i quajtur *Ulzat e Geges/Gegina livadica*, një ditë më herët, Gjokën e kanë ndaluar disa persona të maskuar dhe se e kanë çuar me veturë në drejtim të fshatit Doberdoll/Dobri Dol. Dy ditë më vonë, vëllezërit e Gjokës dhe farefisi i tij kanë mësuar se ekzistonte urdhri për arrestimin e Gjokës, dhe se ai gjendej në burgun e UÇK-së në **Drenoc/Drenovac**. Kur vëllezërit e Gjokës shkuan atje, u thanë se të gjithë të burgosurit u transferuan në zonën e *Drenicës/Drenica*, për shkak të veprimeve luftarake. Familjarët nuk dinin një kohë të gjatë asgjë për fatin e Gjokës. Vetëm në muajin nëntor të vitit 2006, familjarët mësuan se mbetjet mortore të Gjokës ishin zbuluar në varrezat e qytetit të Pejës/Peç dy vjet më herët, dhe se me analizën e ADN-së u konfirmua identiteti i tij. Në datën 22.11.2006, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Gjokës, në varrezat e fshatit Meqe/Meçe.

**Burimet:** deklarata Z.K, FDH-29027; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

## Hasan (Avdi) Morina

(1950, rom nga fshati Senoc/Sanovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, vozitës, nëntë fëmijë)

Hasani punonte si shofer traktori në ndërmarrjen *Piros*, në Rahovec/Orahovac. Në fund të muajit maj të vitit 1998, gjashtë pjesëtarë të UÇK-së erdhën te shtëpia e tij dhe e morën me vete në shtabin e UÇK-së, në fshatin fqinj të **Drenocit/Drenovac**. Atje e mbajtën deri më **17.07.1998**. Më pas, mbahet në mend që e kishin parë të

gjallë për herë të fundit në burgun e UÇK-së në Malishevë/Mališevo. Pas kësaj, atij i humbet çdo gjurmë.

**Burimet:** deklarata A.I, FDH-13456; deklarata A.LI, FDH-35287; AIS, *Zona...*, 61, FDH-16913; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712.

## Đorđe (Ilija) Baljošević

(26.04.1941, serb nga Rahoveci/Orahovac, zjarrfikës, katër fëmijë)

## Duško (Milorad) Dolašević

(30.11.1954, serb nga Rahoveci/Orahovac, zjarrfikës, katër fëmijë)

Nga orët e hershme të mëngjesit, në datën 17.07.1998, njësitet e UÇK-së nën komandën e Gëzim Hamzës kanë nisur të zhvendoseshin nga drejtimi i bjeshkës *Shkëmbi i Vranit/Vran stene* [në afërsi të fshatit Zatriq/Zatrici] dhe të hynin në qytet, duke i kaluar lagjet periferike drejt qendrës së qytetit. Rreth orës 16:00 të së njëjtës ditë, UÇK e ka vendosur kontrollin mbi Shtëpinë e Shëndetit. Nga ora 18:00, pjesëtarë të UÇK-së filluan të shtënin me armë zjarri mbi stationin policor, hotelin *Park*, në të cilin, po ashtu, ishte e pozicionuar policia, si dhe lagjen serbe që ndodhet në bjeshkë. Përpos kësaj lagjeje, njësitet e UÇK-së arritën që ta vendosnin kontrollin mbi tërë qytetin, i cili zgjati nga data 17.07.1998 deri në mesditën e datës 19.07.1998.

Në orët e hershme të mëngjesit, Duško dhe Đorđe shkuan me automobil në fabrikën e valvuleve *Termovent* në fshatin Bërnjak/Brnjača, e cila gjendet tre kilometra larg qytetit, për të riparuar makinën e zjarrfikësve. Që të dy punonin në reparatin zjarrfikës. Duško ka qenë udhëheqës reparti në Rahovec/Orahovac. Đorđe ishte i martuar me motrën e Duškos. Ditën kritike, Đorđe ishte i veshur me uniformën e zjarrfikësve, ndërkaq Duško ishte me rroba civile. I kishin me vete një pushkë automatike dhe radio-lidhjen. Pas dite, e morën rrugën e kthimit për në **Rahovec/Orahovac**. Ushtarë të UÇK-së i ndalën në rrugë